

VENDIM
Nr. 91, datë 8.2.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 546, DATË 27.7.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA TOKË
BUJQËSORE NË TOKË TRUALL, PËR NDËRTIMIN E STACIONIT TË
TRANSFERIMIT TË MBETJEVE
TË BASHKISË POGRADEC”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 546, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, fshati “Çërravë” zëvendësohet me fshatin “Leshnicë” dhe zona kadastrale “nr. 1387” zëvendësohet me zonën kadastrale “nr. 2420”.

2. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Korçë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja 1. Tokë bujqësore (Kategoria VIII)

Bashkia	Njësia administrative	Fshati	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Pronari	Lloji i pasurisë	Kategoria e tokës bujqësore	Truall i kërkuar (m ²)
Pogradec	Çërravë	Leshnicë	2420	77	Tokë Shtet	Arë	VIII	5900